



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4706 Prot.

Roskovec, më 02, 07 2021

VENDIM

NR. 47 DATË 30.06.2021

“PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË LISTËN E INVENTARIT, MIRATUAR ME VKM NR. 1210, DATË 11.12.2009 “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE ,SHTETËRORE QË TRASFEROHEN NË PRONËSI OSE PËRDORIM TË KOMUNËS KUMAN ,TË QARKUT TË FIERIT”I NDRYSHUAR, DHE VKB NR.50, DATË 29.06.2020 “PËR PËRDITËSIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE QË NDODHEN NË TERRITORIN E NJËSISË ADMINISTRATIVE KUMAN ”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 54, shkronja k); Ligjit Nr.8743, datë 31.07.2000 për “Pronat e paluajtshme të shtetit” (i ndryshuar); Ligjit Nr. 8744, datë 22.02.2001 për “Transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); Ligji 111/2018 “Për kadastrën”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 500, datë 14.08.2001 për “Inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar), Udhëzimit të Ministrit të Pushtetit Vendor nr. 3, datë 18.07.2002 për “Inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore”, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

1- Ndryshimin në :

- Listën e Inventarit të Pronave Publike miratuar me VKM nr. 1210, datë 11.12.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike ,shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të komunës Kuman ,të qarkut të Fierit” ,prona me numër rendor 22, Truall + ndërtesë, me nr.pasurie 299/1 ,ZK 2497 , Shkolla 9 vjecare fshati Luar ndryshohet nga sipërfaqe 12375 m2 truall+ 487m2 ndërtesë në sipërfaqen 2435 m2 truall + 487 m2 ndërtesë.



- Listën e inventarit të pronave publike miratuar me VKB Nr 50, datë 29.06.2020 *“Për përditësimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Njësisë administrative Kuman”* ,prona me nr. rendor 23, me numër pasurie 299 ZK 2497, Shkolla 9 vjecare fshati Luar , indeks harte 231-A, ndryshohet nga sipërfaqe 12375 m2 truall+ 487m2 ndërtesë në sipërfaqen 2435 m2 truall + 487 m2 ndërtesë.
- Të shtohet :
 - a) Në listën e inventarit të pronave publike ,prona me nr. rendor 349, me nr.pasurie 299/B, zk 2497 ,indeks harte 231-B ,**Terrene sportive** ,me sipërfaqe 9760 m2.
 - b) Në listën e inventarit të pronave publike ,prona me nr. rendor 350, me nr.pasurie 299/C ,zk 2497 ,indeks harte 231-B,**Truall** ,me sipërfaqe 180 m2.
- 2- Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, për zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.
- 4- Bashkëlidhur këtij vendimi:

- Relacionin shpjegues
- Certifikatën e pronësisë nr.1955829
- Listën e inventarit te pronave publike miratuar me *VKM nr. 1210, datë 11.12.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike ,shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të komunës Kuman ,të qarkut të Fierit”*
- Listën e inventarit te pronave publike miratuar VKB nr.50, datë 29.06.2020 *“Për përditësimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Njësisë administrative Kuman*
- Formulari i inventarizimit të pronave publike

Sasia e ekzemplarëve të shtypur:5

